

VENDIM
Nr. 640, datë 7.9.2016

**PËR KALIMIN E SPORTELEVE TË SHËRBIMIT TË FONDIT TË
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË
ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE
TË INTEGRUARA (ADISA)**

(përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 50, të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit në sportel të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e sporteleve të shërbimit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) në administrim të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), në bashkitë Kavajë, Fier, *Tiranë*, *Krujë*, *Gjirokastrë*¹ dhe *Shkodër*².
2. Për një periudhë kohe deri në konsolidimin e mënyrës së ofritit të shërbimeve, ky shërbim do të ofrohet, njëkohësisht, nga ADISA dhe FSDKSH- ja.
3. Ngarkohen Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

¹ Shtuar me Vendimin Nr. 327, datë 12.04.2017 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në Vendimin nr. 640, datë 7.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e sporteleve të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm në administrim të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”;

² Shtuar me Vendimin Nr. 98, datë 23.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në Vendimin nr. 640, datë 7.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e sporteleve të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në administrim të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”, të ndryshuar;